



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 01.09.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 10 dhe 33 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit 01 Nr. 06-7665-9/1 të mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të dt. 27.08.2015, e ndërlidhur me kërkesën e Drejtorisë për Shërbime Publike, për lejimin e pagesës së shpenzimeve të varrimit për Sakibe Bejtullau-Hoxha me dt. 01.09.2015, e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Shërbime Publike për lejimin e pagesës së faturës së N.t.sh “Mimoza” me nr. të faturës 96/2015 e dt. 17.08.2015 në vlerë prej 590 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për Sakibe Bejtullau-Hoxha nëna e dëshmorit Kushtrim Nexhbedin Hoxha.

2. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në vlerën totale prej 590 nga subvencionet e Drejtorisë për Shërbime Publike në emër të shërbimeve të kryera nga N.t.sh “Mimoza” me nr. të faturës 96/2015 e dt. 17.08.2015 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit të Sakibe Bejtullau-Hoxha nga Gjakova, sipas shënimeve të përshkruara në pikën paraprake.

3. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 590€ nga subvencionet e Drejtorisë për Shërbime Publike për bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e N.t.sh “Mimoza” nr. 1505001000139475 në Raiffeisen Bank.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

5. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Shërbime Publike
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- N.t.sh “Mimoza” Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari- Lila

